

20120601653

**L I G J**  
**PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE NË BANKEN**  
**NDERKOMBETARE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM – BANKEN BOTERORE**  
**SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM PLOTESUES TË PROJEKTIT**  
**PËR PERMIRESIMIN E SHERBIMEVE TË KOMUNAVE**

Neni 1

Republika e Maqedonise ngarkohet me hua në Banken Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim – Banken Boterore në shume prej 37 200 000 eurosh, të dedikuar për realizimin e financimit plotesues të Projektit për permiresimin e sherbimeve të komunave.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje për hua për financim plotesues të Projektit për permiresimin e sherbimeve të komunave, që do të lidhet ndermjet Republikes së Maqedonise dhe Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim – Bankes Boterore.

Në emer të Republikes së Maqedonise, Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i ketij neni do ta nenshkruaje ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesen e huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 18 vjet, me grejs periudhe të perfshire prej pese vitesh.

Shkalla e kamates eshte LIBOR gjashtemujor për valute euro me shtrirje variabile.

Pas nenshkrimit të Marreveshjes për hua nga neni 2 paragrafi 1 i ketij ligji, Republika e Maqedonise do t'i paguaje Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim – Bankes Boterore provizion të njefishte në shume prej 0,25% të shumes së huas.

Huaja do të paguhet në 26 keste gjysmevjete, më çdo 15 shkurt dhe 15 gusht të vitit. Nga 15 gushti 2017 deri më 15 gusht 2029 do të paguhet 25 keste gjysmevjete secili në shume prej 3,85% të shumes së huas, ndersa më 15 shkurt 2030 do të paguhet kesti i fundit në shume prej 3,75% të shumes së huas.

Neni 4

Shfrytezues të mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji jane komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit që i plotesojne kushtet për huamarrje në pajtim me Ligjin për borxh publik dhe Ligjin për financimin e njesive të vetadministrimit lokal.

Neni 5

Për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve ndermjet Republikes së Maqedonise dhe shfrytezuesve të mjeteve të huas nga neni 4 i ketij ligji, Ministria e Financave do të lidhe marreveshje të vecanta për hua.

Neni 6

Me shfrytezuesit e mjeteve të huas nga neni 4 i ketij ligji që do t'i plotesojne kushtet për marrjen e grandit në pajtim me Marreveshjen për hua nga neni 2 i ketij ligji, Ministria e Financave do të lidhe marreveshje të vecanta për grand.

Neni 7

Republika e Maqedonise huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga mjetet që do të grumbullohen me pagesen e mjeteve të huazuara nga shfrytezuesit e mjeteve të huas nga neni 4 i ketij ligji, në pajtim me marreveshjet e vecanta për hua nga neni 5 i ketij ligji dhe nga Buxheti i Republikës së Maqedonise.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise”.